



Mijëra shqiptarë kanë nisur protestën kundër arrestimeve të shqiptarëve në operacionin "Monstër" lidhur me vrasjen e pesëfishtë në Smilkovc.

Protesta udhëhiqet nga të rinjë pa pankarta dhe materiale të tjera protestuese, ndërsa ata brohorisin për "drejtësi dhe liri", "ndal terrorit shtetëror", "ndal diskriminimit dhe aksioneve antishqiptare", etj.

Reporterët e agjencisë së lajmeve INA raportojnë për protestë të qetë dhe të organizuar.

Ndërkohë, pranë gjykatave në Shkup, ku po pritet të mbërrijnë protestuesit janë të pranishme qindra forca speciale.

Protestuesit në këtë moment po i afrohen pranë gjykatës themelore Shkupi 1, ku u zhvillua edhe procesi hetimor kundër 20 të arrestuarëve shqiptarë në rastin e Smilkovcit, ku ndër të arrestuarit kishte gra të moshuara dhe vajza shqiptare, që u lanë të pafajshme, por që deklaruan se ishin maltretuar dhe terrorizuar psikikisht nga organet policore.

Protestuesit pas qëndrimit për disa minuta pranë Gjykatës Themelore , tani janë drejtuar në drejtim të Qeverisë dhe se vijojnë brohoritjet dhe parullat për drejtësi.

Turma e protestuesve është nga ura që shkon në drejtim të Qeverisë dhe supozohet për mijëra veta.

Brohoritjet masive dëgjohen para Qeverisë "Shqiptarët nuk janë terroristë", "Shqiptarët nuk janë radikalë islamik", "Stop proceseve të montuara", "Allahu është i madh", etj. Në mesin e brohoritjeve janë dëgjuar edhe thirrje fetare islame nga disa protestues.

Në mesin e protestuesve ka pasur protestues që kanë tentuar që ti heqin barrikadat pranë

gjykatës, mirëpo ato janë penguar dhe nuk janë lejuar nga organizatorët.

Qytetarët protestues janë të indinjuar me mospraninë e përfaqësuesve politik shqiptarë nga radhët e partive politike shqiptare.

"Ku janë ata, pse janë futur nëpër frimat e mijëve, apo kanë hipoteka e nuk guxojnë ti bëjnë zë shkaut e Gruevskit. Pse po heshtin edhe ato tjerat parti. Kur dojnë ato me bo politikë apo me i realizu qëllimet e veta dhe përmes kujt. Le të dalin këtu dhe të thirrën protesta masive. është koha e fundit të tolerohen këto skena makabre dhe sulme ndaj familjeve shqiptare", thekson një protestues i revoltuar për agjencinë e lajmeve INA.

Protestuesit janë larguar nga Qeveria në drejtim të Bit Pazarit , ku edhe janë rrëzuar disa kontejnerë bërloqesh dhe janë djegur në rrugë.

Akoma nuk dihet marshimi i tyre i mëtejshëm, për shkak se bëhet fjalë për turma të mëdha njerëzish, një pjesë e të cilëve është shpërndarë pas protestës para Qeverisë.

Protesta ka kaluar e qetë dhe se ka pasur tentime individuale nga ana e protestuesve për të përplasur me pjesëtarë të njësive speciale policore, informon INA nga terreni.

"Vrasës", "Kaurë", "Pederastë politikan", "Poshtë partitë", "Ndal proceseve të montuara politike" kanë qenë disa nga parullat e tjera që janë dëgjuar nga protestuesit.

Protesta ka përfunduar dhe protestuesit janë shpërndarë në drejtim të ndryshme, pas qëndrimit dhe brohoritjeve disa minutëshe pranë komunës së Çairit.

Protesta ka përfunduar dhe protestuesit janë shpërndarë në drejtim të ndryshme, pas qëndrimit dhe brohoritjeve disa minutëshe pranë komunës së Çairit.

Pranë komunës së Çairit ka qenë vetëm qindra protestuesit, një pjesë e të cilëve kanë gjuajtur gurë në drejtim të godinës së komunës. Nuk ka pasur prani të shtuar policore, përveç disa policëve të rregullt që kanë ndjekur protestën. /INA/

Q4w14ZiZ4ts#at=11